



Pranuar / Dorezuar Priljeno/Prudato Received/Bezbray	15-03-2023	3	viti god Year
Organ /Dhësia Organ /Jedinstvo Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shloja Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKM/SHK	2720/2023		113



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.287/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë , si dhe me Kaltrina Avdullahi Prenaj - Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.287/2023 të datës 31.01.2023 të parashtruar nga ankuesi adresë:

kundër organit të punësimit/Shërbimi Korrektues i Kosovës, në çështjen juridike "Transferim", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 15.03.2023, mori këtë:

V E N D I M

PËRFUNDON procedimi administrativ i iniciuar sipas ankesës me numër A.nr.287/2023 të datës 31.01.2023 të parashtruar nga ankuesi.

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Shërbimin Korrektues të Kosovës sipas Akt Emërimit me numër Nr.066/2022 të datës 04.07.2022, me datën 31.01.2023 ka parashtruar ankesën me numër protokolli 1125/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila në Këshill është pranuar po me këtë datë nën shenjen A.nr.287/2023, kundër Vendimit me Nr.121 të datës 26.01.2023 të lëshuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës lidhur me transferimin e përkohshëm të ankuesit nga pozita Drejtor i Qendrës së Paraburgimit në Gjilan, në Drejtor i Qendrës së Paraburgimit në Pejë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 15.02.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Shërbimin Korrektues të Kosovës. Ndërsa Këshilli,

me datën 14.03.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë nga ky institucion së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova:** Ankesën me numër të protokollit 1125/2023 të datës 31.01.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Akt Emërimit e ankuesit me numër Nr.066/2022 të datës 04.07.2022; Vendimin Nr.121 të datës 26.01.2023 të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës; Vendimin Nr.0494 të datës 04.05.2022; Vendimin Nr.1176 të datës 15.10.2021; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 15.02.2023 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 01.03.2023 nga Shërbimi Korrektues i Kosovës së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës; Formularin mbi përkrimin e detyrave të punës së ankuesit të datës 01.08.2014; E-mailin zyrtar të datës 14.03.2023 si dhe Vendimin me numër protokollit Nr.297 të datës 13.03.2023 i Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkëngjitura të lëndës të dërguara si nga ankuesi ashtu edhe nga organi i punësimit, ka konstatuar se objekti për të cilin ka filluar procedimi administrativ me ankesën e ankuesit është bërë i pamundur, sepse:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, bazuar në provat e lëndës ka konstatuar se ankuesi është i punësuar në Shërbimin Korrektues të Kosovës sipas Akt Emërimit me numër Nr.066/2022 të datës 04.07.2022, në pozitën „Drejtor i Qendrës së Paraburgimit në Gjilan“. Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës më datë 26.01.2023 ka nxjerrë Vendim me Nr. 121 me cilin ankuesin e ka transferuar përkohësisht nga pozita Drejtor i Qendrës së Paraburgimit në Gjilan në pozitën Drejtor i Qendrës së Paraburgimit në Pejë.

Ankuesi me datë 31.01.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 1125/2023, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimi me Nr. 121 të datës 26.01.2023 të Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës me pretendime ankimore se Vendimi për transferim është nxjerrë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, gjegjësisht ankuesi pretendon që të anulohet Vendimi me Nr. 121 i datës 26.01.2023 i Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës, lidhur me transferimin e përkohshëm nga pozita Drejtor i Qendrës së Paraburgimit në Gjilan në pozitën Drejtor i Qendrës së Paraburgimit në Pejë, dhe i njëjti kërkon që të kthehet në vendin e punës në Qendrën e Paraburgimit në Gjilan.

Shërbimi Korrektues i Kosovës përmes Menaxherit të Personelit , me datën 14.03.2023, përmes emalit zyrtar ka dërguar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës përgjigjen në ankesë lidhur me ankesën e ankuesit duke përcjell si provë Vendimin me Nr. 297 të datës 13.03.2023 të Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës, përmes të cilit është bërë shfuqizimi i Vendimit me Nr. Port: 121 i datës 26.01.2023 për transferimin e përkohshëm të ankuesit nga pozita Drejtor i Qendrës së Paraburgimit në Gjilan, në Drejtor i Qendrës së Paraburgimit në Pejë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, bazuar në këto rrethana, ka konstatuar se meqenëse me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numer protokolli 297 të datës 13.03.2023 të Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës, përmes të cilit është bërë shfuqizimi i Vendimit me Nr. Port: 121 i datës 26.01.2023 për transferimin e përkohshëm të ankuesit nga pozita Drejtor i Qendrës së Paraburgimit në Gjilan, në pozitën Drejtor i Qendrës së Paraburgimit në Pejë, i cili ka qenë edhe pretendim i ankuesit, atëherë Kolegji konsideron që objekti për të cilin ka filluar procedimi administrativ me ankesën e ankuesit është bërë i pamundur apo i kotë sepse me këtë rast pretendimi i ankuesit është përmbushur apo realizuar, dhe mbi këtë bazë nuk ka me objekt shqyrtimi gjegjësisht objekti i lëndës është bërë i pamundur, ashtu siç përcaktohet me dispozitat ligjore të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenin 104 i cili thekson se: *“Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë”*, andaj ne rastin konkret Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se janë plotësuar kushtet për përfundimin e procedimit administrativ të iniciuar sipas ankesës me numër A.nr.287/2023 të datës 31.01.2023 të parashtruar nga ankuesi

Theksuar si më sipër, e duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:** *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

## KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër: A.nr.287/2023

Kaltrina Aydullahi-Prenaj

Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit



**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMShCK-së

